



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI I KONKURRENCËS**

### **Njoftim për shtyp**

Komisioni Për Mbrojtjen e Konkurrencës në Serbi, me rastin e 12 vjetorit të krijimit të institucionit dhe Ditës Kombëtare Serbe të Konkurrencës, organizoi në datën 20 Prill 2018 në Beograd, Konferencën me temë: “New Competition Agenda”.

Kryetarja e Autoritetit të Konkurrencës, Prof. Dr. Juliana Latifi, ishte e ftuar të prezantojë eksperiencën shqipëtare në panelin “New agenda for the region- Sfidat e autoriteteve të konkurrencës biznesi, politika, mjedisi konkurrues dhe inovacioni”.

Në këtë panel morren pjesë kryetarët e autoriteteve të konkurrencës në rajon: Kroaci, Sloveni, Maqedoni, Turqi dhe përfaqësues nga Komisioni Europian.

Gjatë diskutimeve u evidentua roli dhe rëndësia e bashkëpunimit mes vendeve të Ballkanit Perëndimor për zbatimin e politikës dhe ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, si dhe shkëmbimit të ideve apo eskperiencave ndërmjet autoriteteve të konkurrencës duke ndjekur standartet Europiane si në përafrimin e kuadrit ligjor ashtu edhe në ndjekjen në praktikë të rasteve konkrete.